



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 233 Prot.

Tiranë, më 16.022018

VENDIM Nr. 19, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik* në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Vojak KP 130+860-131+066, në kuadër të *projektit "Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik" (TAP)*- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik* në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Vojak KP 130+860-131+066, në kuadër të *projektit "Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik" (TAP)*- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Subjekti "SPIECAPAG Shqipëria" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë gërmimin arkeologjik në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Vojak KP 130+860-131+066, në kuadër të projektit "Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik" (TAP), si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO-FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO